



**Për: Universitetin Publik "KadriZeka" në Gjiçan
Këshillin e Fakultetit Juridik**

Nga: Komisioni i Ankesave

Lënda: Raport për shqyrtimin e ankesave të kandidatëve për profesor dhe asistent të angazhuar për vitin akademik 2020/2021 sipas konkursit publik

Komisioni i Ankesave në përbërje: 1. Prof.Ass.Dr. Albulena Hajdari Krasniqi, Kryetare, 2. Prof.Ass.Dr. Fatmire Krasniqi anëtare dhe 3. Ass.PhD.Cand Detrina Alishani Sopi anëtare, në mbështetje të nenit 15 të *Rregullores mbi Procedurat e Angazhimit të Bashkëpunëtorëve të Jashtëm - me Honorar në Universitetin Publik "Kadri Zeka" në Gjiçan*, në mbledhjen e mbajtur, datë 22.10.2020, pas shqyrtimit të të gjitha ankesave të parashtruara nga kandidatët për angazhim në Fakultetin Juridik për vitin akademik 2020/2021 sipas Konkursit me Nr.Ref.01/1182, të datës 24.09.2020, paraqiti:

**R A P O R T
PËR SHQYRTIMIN E ANKESAVE
PËR ANGAZHIMIN E BASHKËPUNËTORËVE TË JASHTËM – ME HONORAR**

Komisioni i Ankesave ka shqyrtuar dhe vlerësuar ankesat dhe ka konstatuar si në vijim:

Pozita nr.III/9: Tre asistentë për semestrin dimëror dhe veror për lëndët: Hyrje në të drejtën penale, E drejta penale, E drejta e procedurës penale, Taktika kriminalistike, Kriminologji me penologji, Përgjegjësia penale e personave juridikë, Mjekësia ligjore, Kriminalistika, Politika kriminale, Krimet kibernetike, Klinika juridike penale, E drejta penale - Pjesa e posaçme, E drejta e procedurës penale-Pjesa e posaçme, Viktimologjia dhe E drejta penale ndërkombëtare.

Për këtë pikë të konkursit ka ushtruar ankesë kandidatja:

1. Ma. Sc. Teuta Gashi

Pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore dhe shqyrtimit të dosjeve të kandidatëve, veçanërisht të kandidatëve të pranuar për Pozitën III/9, Komisioni i Ankesave vlerëson se në procedurën e përzgjedhjes së kandidatëve nga ana e Komisionit Vlerësues nuk janë evidentuar shkeljet e pretenduara si në ankesën e kandidatës. Të gjithë kandidatët e propozuar nga Komisioni vlerësues i plotësojnë kushtet e përcaktuara në *Konkurs* dhe në *Rregulloren mbi procedurat e angazhimit të bashkëpunëtorëve të jashtëm - honorar*. Prandaj, në mungesë të evidentimit të ndonjë shkeljeje, Komisioni konstaton se ankesa e kandidatës është e papabuar.




Anëtarët e Komisionit të Ankesave:

1. Prof. Ass. Dr. Albulena Hajdari Krasniqi, Kryetare: _____

2. Prof. Ass. Dr. Fatmire Krasniqi, Anëtare: _____

3. Ass. PhD. Cand. Detrina Alishani, Anëtare: _____



Gjilan, 22.10.2020